

**L I G J**  
**Nr.8062, datë 8.2.1996**

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË BASHKËSISË EKONOMIKE TË ALBAKRIT**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Falen detyrimet e prapambetura që ka bashkësia ekonomike e Albakrit në shumën 350 milionë lekë, të ndara si më poshtë:

- a) Ndaj buxhetit të shtetit për fondin kundërparti, në shumën 210 milionë lekë.
- b) Ndaj buxhetit të shtetit për tatim mbi fitimin, në shumën 74 milionë lekë.
- c) Ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për kontributin e pashlyer gjer më 31.12.1994, në shumën 66 milionë lekë.

**Neni 2**

Për detyrimet e falura bashkësia ekonomike e Albakrit të bëjë rregullimet në kontabilitet, duke i sistemuar me kapitalin themelor.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.1372, datë 16.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqiprisë, Sali Berisha**